



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2019

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR ME PENSION SHËRBIMI TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT QË NDËRPRESIN MARRËDHËNIET E PUNËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është t'u garantojë punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhëniet e punës, trajtim financiar për pension shërbimi.

**Neni 2
Subjektet përfitues**

Subjekt i trajtimit financiar, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, me pension shërbimi sipas këtij ligji, janë punonjësit e Policisë së Shtetit që mbajnë gradë policore dhe që plotësojnë kriteret sipas këtij ligji.

Neni 3

Vjetërsia në shërbim

Për përfitimin e pensionit të shërbimit sipas këtij ligji, njihet si vjetërsi shërbimi, vetëm vjetërsia në strukturat e Policisë së Shtetit.

Neni 4

Paga referuese

Përfitimet, që jepen nga ky ligj, llogariten në bazë të pagës referuese, të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 5

Financimi

1. Përfitimet nga ky ligj financohen nga Buxheti i Shtetit.
2. Llogaritja dhe pagimi i përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj, bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

KREU II

PENSIONI I SHËRBIMIT

Neni 6

Kushtet e përfitimit të pensionit të shërbimit për punonjësin e Policisë së Shtetit

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, me kërkesën e tij dhe me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, fiton të drejtën e pensionit të shërbimit, kur:

- a) Plotëson 25 vite vjetërsi shërbimi në strukturat e Policisë së Shtetit me gradë policore;
- b) Ka mbushur moshën 55 vjeç;

Neni 7

Masa e përfitimit të pensionit të shërbimit për punonjës in e Policisë së Shtetit

1. Masa e pensionit të shërbimit për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, të përcaktuara në nenin 6, është 65 % (për qind) e pagës mesatare referuese neto sipas viteve të qëndrimit në strukturave policore.
2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim mbi 25 vite, në strukturat policore, masa e pensionit të shërbimit e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shtohet me 1 % (për qind) të pagës mesatare referuese neto.
3. Shuma e pensionit të shërbimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk duhet të kalojë 75 % të pagës mesatare referuese neto.
4. Punonjësi i Policisë, që plotëson kushtet e nenit 6 të këtij ligji, përfiton pension shërbimi, pa u trajtuar me pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kreu III

PERIUDHAT E SIGURIMIT

Neni 8

Periudha e sigurimit dhe kontributet

1. Periudha e trajtimit me pension shërbimi njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Kontributi për këto periudha përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet në bazë të pagës mujore sipas së cilës është llogaritur përfitimi mujor, i indeksuar çdo vit me koeficientet e indeksimit të bazës së vlerësuar, por në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt të pagesës së kontributeve të detyrueshme.
2. Kur përfituesi i pensionit të shërbimit punësohet, veprohet sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të

Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" , të ndryshuar.

Neni 9 Indeksi

Pensioni i shërbimit indeksohet. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10 E drejta për përfitim

Përfitimet e njohura nga ky ligj, trajtohen sipas përcaktimeve në nenin 28 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" , të ndryshuar.

Neni 11 Dispozitë kalimtare

Pensionin e shërbimit, sipas këtij ligji për tre vitet e para, do ta përfitojnë çdo vit, jo më shumë se 30% të punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndërpresin marrëdhëniet e punës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.

Rregullat dhe procedura për paraqitjen e kërkesës dhe miratimin e saj, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI